



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. _____

Datë: 05.10.2017

Në mbështetje të në nenin 28, nenin 35, nenin 36, nenin 38 dhe 54, paragrafi (2) nën paragrafin 2.1, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të dyshimeve për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës me marrëveshje të ndaluar në mes të Furrtarëve, nëpërmjet Shoqatës së Zejtareve, Hotelierëve dhe Afaristëve në Komunën e Pejës, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 05.10.2017 merr këtë:

KONKLUZION

Për

- I. Fillimin e procedurës hetimore ndaj Furrtarëve dhe Shoqatës së Zejtareve, Hotelierëve dhe Afaristëve të Komunës së Pejës, lidhur me dyshimet për marrëveshje të ndaluar në mes furrtarëve për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës nga 0.30 euro ne 0.40 euro.
- II. Ky konkluzion hyn ne fuqi pas nënshkrimit të Komisionit të AKK-së

ARSYETIM

Autoritetit Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare me datën 25 dhe 26.09.2017, ka autorizuar inspektorët hetues që të inspektojnë regjionin e Pejës lidhur me dyshimin për marrëveshje të ndaluar në mes Furrtarëve për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës. Inspektorët hetues, me datën 25.09.2017 kanë kontaktuar me zyrtar të Komunës së Pejës, z. Fatmir Asllani drejtor i Administratës dhe me datën 26.10.2017 kemi takuar z. Artan Gashi – drejtor i Departamentit për zhvillim ekonomik. Të cilët ndan shqetësimet e tyre se ata përmes një marrëveshje kane ngritur çmimet e bukës. Si komune ata kane mbajtur një takim me furrtar mirëpo ata nuk kane pranuar të kthejnë çmimin në 0.30 euro.

Inspektorët hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës gjatë monitorimit të tregut dhe bisedës me disa pronar të furrave të bukës (z. Smajl Temaj – pronar i furrës Liria, z. Elhami Maroshi – pronar i furrës Dielli 2, dhe z. Shpëtim Alimusaj – pronar i Fabrikës së re të brumërave) dhe Kryetarin e Shoqatës të Zejtareve, Hotelierëve dhe Afaristëve të Komunës së Pejës, të njëjtit kanë

pranuar se me datën 18.08.2017 kanë mbajtur Mbledhje në qendrën tregtare zejtare Iliriana dhe janë marrë vesh për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës nga 0.30 euro në 0.40 euro.

Shoqata e Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve, e cila udhëhiqet nga z. Ismet Shala – Kryetar, ka pranuar me procesverbal para inspektorëve hetues se ka thirrur dhe organizuar këtë mbledhje me kërkesën e disa pronarëve të furrave të qytetit të Pejës me këto pika të rendit të Mbledhjes:

1) Biseda rreth çmimit të bukës. 2) Të ndryshme!

Fiksimit/ngritjes së çmimit të bukës i ka paraprirë edhe takimi i dytë i të apostrofuuarve më lartë dhe furrtarëve tjerë, në lokacionin restaurant Delta në Pejë. Ky takim ka ndodhur afërsisht sipas deklarimeve të tyre më 25.08.2017. Aty janë marrë vesh që nga data 1 shtator 2017 të ngritin çmimin e bukës nga 0.30 ne 0.40 euro. Inspektorët hetues gjatë shqyrtimit paraprak në tregun relevant ka hasur në çmime të bukës me ngritje me 0.40 euro.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kërkon nga Furrtarët dhe Shoqata e Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve e Komunës së Pejës, që në afat prej 10 ditësh t'i sjellin në AKK këto dokumente:

1. Statutin e Shoqatës, Rregulloren e brendshme mbi funksionimin e Shoqatës, kopjen e Marrëveshjes së Furrtarëve dhe procesverbalet e Mbledhjeve (e datës 18.08.2017 dhe 25.08.2017) ndërmjet Shoqatës Zejtare dhe Furrtarëve të mbajtur në ndërtesën Iliriana dhe restorant Delta, për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës.
2. Faturat e blerjeve para ngritjes së çmimit të bukës.
3. Faturat e blerjeve pas ngritjes së çmimit të bukës.
4. Faturat e shitjeve para ngritjes së çmimit të bukës.
5. Faturat e shitjeve pas ngritjes së çmimit të bukës.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës nuk është e lejuar ankesa dhe nuk është e lejuar padia për iniciimin e konfliktit administrativ.

KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS

(_____)

Valon PRESTRESHI

Kryetar

(_____)

Ahmet KRASNIQI

Zv. Kryetar

(_____)

Fatime HAZIRI

Anëtare

(_____)

Shaqir MORINA

Anëtarë

(_____)

Muhamed KRASNIQI

Anëtarë

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Palët*

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr.21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1 Tel: +381 /0/ 38 200 10 930